



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC  
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 226

Më:08.05.2023

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën me numër protokollit 747 i dt.12.04.2023 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në SHMLT “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlorë , Berat dhe Krujë. Ekskursioni zgjat 3 bujtje (gjithsejt tri bujtje gjegjësisht katër ditë ,pansion i plotë) prej datës 23.05.2023 deri më 26/05/2023.

Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maturantëve të Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë:

1. N.P.T. “Kushtrimi –NMI ” me çmim 125.00€;
2. SH.P.K. ”Meti –Tours” me çmim 115.00 €;
3. SH.P.K. “Meti -Comerc ” me çmim 145.00 €;

#### Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.25/04/2023 në ora 15:25 sipas ofertës nr.747 i dt.12/04/2023 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Komisionit :

- 1.znj.Florentina Gjergjaj drejtor i shkollës -Kryesuese,
- 2.znj.Mineta Bordoniqi Përfaqësuese e Këshillit Drejtues të Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë -anëtare,
- 3.znj.Flutur Këpuska zyrtare e DKA- anëtare dhe
- 4.z.Bujar Nuqi – Zyrtar ligjor i DKA-së (procesmbajtës)

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

**Firma transportuese N.P.T. “Kushtrimi –NMI”** ka konkuruar me çmim prej 125.00€ për nxënës. Oferta bazohet në 3 (tri) bujtje me pansion të plotë dhe shëtitje, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel “KAMOMIL” të Shkëmbi i Kavajës –Durrës. Janë të përfshirë 3 (tre) shoferë e të pajisur me çertifikatë mjekësore dhe janë prezantuar 5 autobusë.

Posedojnë Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçenë kjo e vlefshme nga dt.15/04/2021 gjer me dt.14/04/2026 dhe dy letër Referenca dt.28.03.2019dhe ref.nr.188 dt.29.03.2019.

Ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit, dhe Vërtetimin Tatimor , Licencën e Punës Dr.Xhevat Musaj së bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania “Kushtrimi –NMI” për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturantët).



Ka prezantuar Licencën e punës së hotelit “KAMOMIL” me pronar Jorida Zoga,por i mungon konfirmim rezervimi nga administratori Jorida Zoga të Hotelit në fjalë.

**Firma transportuese SHPK “Meti –Tours”** ka konkuruar me çmim prej 115.00€, për nxënës ku iu është ofruar qëndrim në hotelin “ELBA PREMIUM”sh.p.k. në Shkëmbi i Kavajës -Durrës . Në ofertë përfshihen tri (3) bujtje me pansion të plotë që nga dt.23/05/2023 gjerë më dt.26/05/2023. Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë bëhen sipas kërkesës së ofertës. Gjithashtu kompania “Meti Tours” ofron dy nxënës falas të përzgjedhur nga stafi i shkollës dhe transportin falas për maurantët në mbrëmjen e maturës.

Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licenë kjo e vlefshme nga dt.07./06/2019 gjer me dt.06/06/2024 ,posedon Çertifikatën e Regjistrimit të kompanisë Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maurantëve) të shkollës. Janë të përfshirë 3 shoferë të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 3 autobusë me konfirmim të rregullësisë teknike. Kompania “Meti Tours” ka prezantuar Kontratë bashkëpunimi me Hotel “ELBA Premium” administrator z.Henri Demce bashkangjitur edhe Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve të hotelit “Elba Premium “me NIPT: L71428503T me pronar z, Henri Demce dhe Çertifikatën për ushtrimin e veprimtarisë së hotelit “Elba Premium “ me të njëjtin NIPT L71428503T dhe pronar.

**Firma transportuese SHPK ”Meti - Comerc”** ka konkuruar me çmim prej 145.00€, për nxënës Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë si në Tiranë, Krujë, Vlorë dhe Berat.

Sipas ofertës së prezantuar nuk është ofruar emri i Hotelit për qëndrimin e nxënësve.

Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, liçencë kjo e vlefshme nga dt.08/03/2021 gjerë më dt.07/03/2026. Ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit të kompanisë.

Nuk posedon Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maurantëve) të shkollës. Janë të përfshirë 2 shoferë dhe 2 autobusë por jo të pajisur me Çertifikatën mjekësore që janë kërkuar në ofertë. Ka mungesë të dokumentacionit.

#### **Vlerësimi i Komisionit selektues:**

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurrese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç`rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga KDSH është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.02.05.2023 ju janë prezantuar Pëlqimet e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta (9 klasë) si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta.




Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë të përzgjedhet firma “Meti Tours” në Gjakovë me çmim prej 115.00€

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike “Meti Tours” në Gjakovë me Menaxher z.Hysen Musa nga Gjakova.

## Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasëve të 12-ta , Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 10 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues nga KDSH jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë të për zgjedhet firma “Meti Tours” Gjakovë **me çmim prej 115.00€**, gjithashtu Hoteli “Elba Premium” Shkëmbi i Kavajës, Golem i prezantuar nga agjencia turistike ofron siguri të mjaftueshme që të mos ketë hyrje dhe dalje nga persona të pa autorizuar (rrethoja) të paraparë sipas pikës 5 të Kërkesës për ofertë me numër të protokollit 747 i dt.12/04/2023 të shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë.

Komisioni selektues:

1.Florentina Gjergjaj (emri dhe mbiemri)	<u>Kryesuese e Komisionit</u> (pozita)	dt. 08 /05/2023 
2.Mineta Bordoniqi (emri dhe mbiemri)	<u>Anëtare</u> (pozita)	dt. 08 /05/2023 
3.Flutur Këpuska (emri dhe mbiemri)	<u>Anëtare</u> (pozita)	dt. 08 /05/2023 

**Këshilla juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatit prej 7 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Agjencive turistike
- Komisionit të Ankesave
- Shërbimit juridik
- Arkivit

